


Bibël për fëmijët paraqet

Bujku dhe Fara



Shkruar nga: Edward Hughes

Ilustruar nga: M. Maillot; Lazarus

Adaptuar nga: E. Frischbutter; Sarah S.

Përkthyer nga: Arianit Iljazi

Prodhuar nga: Bible for Children
www.M1914.org

©2013 Bible for Children, Inc.

E drejta e kopjimit: Mund të bëni kopje ose ta shtypni këtë histori,
nëse nuk do ta shitni.



Një ditë, Jezusi po mësonte
njerëzit anës së një liqeni.
Shumë njerëz u mblodhën
për ta dëgjuar Atë.

Turma u bë tepër e
madhe. Çfarë do të
bënte Jezusi?




Duke parë një varkë aty pranë,
Jezusi hipi mbi të. Tani ai mund ti
shihte të gjithë, dhe ata mund
ta shihnin dhe dëgjonin Atë.



Jezusi filloi të tregojë shëmbëllyra -
ngjarje rreth gjërave të zakonshme,
që mund ti mësonin njerëzve
për Perëndinë.



“Një bujk mbolli farën në fushën e tij”.
Historia e Jezusit ishte si një pikturë
me fjalë në vend të vizatimeve.





Njerëzit mund ta parafytyronin bujkun
ndërsa punonte - ata e kishin parë këtë
gjë shumë herë.




Disa nga këto fara
ranë përgjatë rrugës.
Ciu! Zogjtë shpejt zbritën
poshtë për ti gëlltitur.




Disa fara ranë në pjesën me gurë të fushës. Ato u rritën shpejt si bimë vocërrake e të holla. Dielli i nxehtë i thau ato sepse nuk kishin hedhur dot rrënjë në tokën e cekët plot gurë.



Disa fara të tjera
hodhën rrënjë, në mes të
ferrave. Ato nuk dhanë fryt.
Gjembat ia zunë frymën
bimëve-filiza duke mos i
lënë të shohin as diell
dhe as shi.



Pjesa tjetër e farave ra në tokë të mirë. Ndërsa koha kaloi, filizat u bënë bimë të shëndetshme duke dhënë grurë me shumicë. Bujku do të jetë gëzuar shumë.




Në fund të kësaj historie, dishepujt erdhën tek Jezusi. "Përse ti mëson me shëmbëllyra?" e pyetën ata.



Jezusi u tha atyre se shëmbëlltyrat i ndihmojnë
njerëzit të kuptojnë Perëndinë, nëse ata me
të vërtetë e duan atë.



Jezusi e shpjegoi
shëmbëllyrën. Ai tha, se
fara, është Fjala e Perëndisë.



Fara që ra përgjatë rrugës
është si dukush që e dëgjon, por
nuk e kupton Fjalën e Perëndisë.

Satani i bën,
që ata të
harrojnë

çfarë
Perëndia
thotë.





Disa njerëz e pranojnë nxitimthi Fjalën e Perëndisë. Ata janë si fara në terren të gurtë. Sapo dikush fillon ti tallë, ose i vë në vështirësi për të provuar dashurinë e tyre ndaj Perëndisë, një gjë e trishtueshme ndodh.



Të njëjtët njerëz, që në fillim me gëzim
deshën të ndjekin Jezusin, kthejnë krahët
dhe nuk i binden më Fjalës së Perëndisë.



Ata nuk janë të gatshëm të paguajnë
çmimin që nevojitet për të ndjekur
Perëndinë. Sa e trishtueshme është
që ata duan ti pëlqejnë më shumë
miqve të tyre sesa Perëndisë.



Gjembat në
shëmbëlltysë
janë si ato
shqetësimet e botës
dhe dashuria për
para që robëron
zemrat e disa
njerëzve. Ata janë
kaq të zënë duke
bërë para dhe duke
kërkuar gjëra të
tjera, sa që ata e lënë
Perëndinë jashtë
jetëve të
tyre.



Por fara që ra në tokë të mirë dhe dha shumë fryt, është si Fjala e Perëndisë që hyn në zemër dhe ndryshon jetët e njerëzve. Këta njerëz i shërbejnë dhe i binden Perëndisë.



Turmat nuk deshën të largohen. Shumë prej tyre donin të ndiqnin Jezusin dhe ti pëlqejnë Atij. Shëmbëlltyra e Jezusit i ndihmonin ata të kuptonin sesi ti bindeshin Perëndisë.



Bujku dhe Fara

Një tregim nga Fjala e Perëndisë, Bibla

e marrë nga

Mateut 13

"Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u
jep mendje njerëzve të thjeshtë."

Psalmet 119:130



Fund



Ky tregim nga Bibla na tregon për Perëndinë tonë të
mrekullueshëm i cili na krijoi dhe dëshiron që
ne ta njohim Atë.

Perëndia e di që ne kemi bërë gjëra të këqija, të cilat Ai i quan
mëkate. Dënimi për mëkatin është vdekja, por Perëndia ju do juve
aq shumë sa që dërgoi Birin e Tij të vetëm, Jezusin, që të vdesë në
Kryq dhe të dënohet për mëkatet tuaja. Pastaj Jezusi u ringjall
dhe u ngrit lart në Qiell! Nëse beson në Jezusin dhe i kërkon Atij
të t'i falë mëkatet e tua, Ai do ta bëj atë! Ai do të vijë dhe do të
jetojë në ty, dhe ti do të jetosh me Të përgjithmonë.

Nëse ti beson se kjo është e vërteta, drejtoju Perëndisë kështu:
Jezus i dashur, unë besoj se Ti je Perëndia i bërë njeri për të
vdekur për mëkatet e mia, dhe që Ti u ngjalle sërish. Të lutem,
eja në jetën time dhe fali mëkatet e mia, në mënyrë që unë të kem
jetë të re dhe një ditë të jem me Ty, përgjithmonë. Më ndihmo,
të të bindem dhe jetoj për Ty, si fëmija Yt. Amen.

Lexo Biblën dhe bisedo me Perëndinë çdo ditë! Gjoni 3:16

